



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 98/ Prot.

Tiranë, më 13.01.2026

VENDIM

Nr. 3 Datë 13.01 2026

**“PËR
NISJEN E PROCEDURAVE PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT
"BACHELOR" NË "DIETOLOGJI", ME DIPLOMË TË DYFISHTË, MIDIS
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETI I SHKENCAVE
TË REHABILITIMIT DHE UNIVERSITETIT TË KATANXAROS "MAGNA
GRECIA" NË ITALI DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR
PROGRAMIN”**

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, Vendimin nr. 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, në nenin 7, 43, 73 të Statutit të UST-së, në Rregulloren e UST-së, shkresën nr. 76/2 prot., datë 12.01.2026 prot., datë 07.01.2026 të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit "*Nisja e procedurave për hapjen e programit të ri të studimit në Bachelor në "Dietologji" me diplomë të dyfishtë në bashkëpunim me Universitetin e Katanaxaros "Magna Grecia" në Itali*", pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, në Vendimin e Senatit Akademik nr.7 datë 13.01.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 13.01.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e nisjes së procedurave për hapjen e programit të përbashkët "Bachelor" në "Dietologji" me diplomë të dyfishtë midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe Universitetit të Katanaxaros "Magna Grecia" në Itali.

2. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për programin e përbashkët me Universitetin e Katanxaros "Magna Grecia" në Itali (bashkëlidhur vendimit).
3. Miratimin e pagesave për profesoratin e ftuar për mbulimin e shpenzimeve të transportit, fjetjes, dietën ditore si dhe pagimin për orë mësimdhënie sipas akteve rregullatore dhe marrëveshjes së miratuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

Prof. Asc. Dr. Marsela SHEHU

